



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

Durrës 09.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, mbi pyetjet që ju drejtoni në lidhje me procesin e rindërtimit pas tërmetit, ju sqarojmë se ; referuar Aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ; Për çdo fazë të këtij procesi Bashkia Durrës ka publikuar në faqen zyrtare zhvillimet e procesit të rindërtimit ,listat e subjekteve përfitues nga programet e rindertimit sipas vendimeve përkatëse të këshillit bashkiak Durrës. Në rastin konkret , referuar neni 7 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për Të Drejtën E Informimit “, informacioni që kërkohet bën pjesë në kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e dhënies së informacionit për çdo subjekt është kryer nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë në internet. Informacioni i publikuar mund të konsultohet në çdo kohë nga subkektet e interesuara;

Në lidhje me pikën 7 , 8 të kërkesës ,ju sqarojmë se ;Referuar “Aktit normativ nr.9” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ,përcaktohet qartë qëllimi i ligjit , kriteret dhe subjektet përfituese si dhe procesi i rindërtimit dhe programet e tij. Ky proces ka të bëjë me objekte/banesa dhe me kompleksitetin e problematikave që kanë mbartur kto objekte ndër vite edhe në raport me subjektet pretenduese/ aplikuese; Pikërisht për të shmangur gabime, procesi i rindërtimit ka vijuar me procedura dinamike që zhvillohen dhe ndryshohen sipas situatave specifike duke u zgjatur në kohë.

Në lidhje me bonusin, ,nga momenti i ndodhjes së fatkeqësisë natyrore dhe deri në muajin mars të vitit 2023, bonusi i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti është financuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë sipas Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “ Për përballimin e pasojave

të fatkeqësisë natyrore ”. Ndodhur në këto kushte Bashkia Durrës ka bërë vetëm miratimin e listës përfituese të banorëve me Vendim Këshilli Bashkiak. Nëpërmjet shkresës nr.5897 të Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë, të gjitha bashkitë janë njoftuar se subvencionimi i qirase mbas muajit Mars 2023, nuk do të financohet më nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, por duhet parashikuar nga buxheti i Bashkisë. Proçesi i rindërtimit është drejt përfundimit së bashku me banesat e të dëmtuarve nga tërmeti. Bashkia po mundëson dorëzimin e banesave sa më parë me qëllim akomodimin e familjeve në banesat e tyre te reja. Duke qënë se ka ende objekte të rindërtimit që kanë nevojë për financim, Bashkia Durrës në buxhetin e vitit 2026, ka marrë masa ti japi prioritet investimeve.